

VENDIM
Nr.189 datë 16.4.1993

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.372, DATË 28.8.1992, NDRYSHUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.484, DATË 10.11.1992 "PËR PËRBALLIMIN NGA SHTETI TË SHPENZIMEVE TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT PËR SHTETASIT SHQIPTAR QË VDESIN BRENDË DHE JASHTË SHTETIT"

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit dhe të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.372, datë 28.8.1992, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3 shtohen tre paragrafe me këtë përmbajtje:

"Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe e Rregullimit të Territorit do të përballojë shpenzimet e varrimit sipas pikës 1 të këtij vendimi, vetëm për shtetasit, vendbanimet e të cilëve mbulohen nga shërbimi funeral shtetëror.

Për shtetasit e tjerë këshillat e rretheve dhe komunave, brenda fondeve të tyre, të japin në rast fatkeqësie shpërblim jo më shumë se 3000 lekë, që përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet buxhetit të këshillave të rretheve dhe komunave përkatëse.

Këshillat e rretheve ngarkojnë ndërmarrjet e shtetërore të rretheve përkatëse për heqjen, transportimin dhe rivarrimin e eshtrave të të ekzekutuarve me ose pa vendim gjyqi, të të burgosurve politikë që kanë vdekur në burg pa u dënuar ose në vendet e vuajtjes së dënimit, si dhe të të vrarëve në kufi në orvajtje për t'u arratisur. Shpenzimet përballohen nga këshillat e rretheve përkatëse".

2. Në pikën 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Shpenzimet e transportit, të kryera nga familjarët a të afërmit që nga data 28.3.1992 për sjelljen e kufomave të shtetasve shqiptarë që janë dërguar me shërbim ose kurim jashtë shtetit dhe për shtetasit shqiptarë që kanë qenë me banim në Shqipëri dhe janë larguar pas datës 1.1.1991, përballohen nga fondet e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit që i janë planifikuar për vitin 1993".

3. Efektet sipas këtij vendimi përballohen brenda buxhetit të vitit 1993.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi